



**VENDIM**

*Nr. 145, Datë 25.08.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURES PER MIRATIMIN E KONTRATËS PER SHIT-BLERJEN E ENERGJISE ELEKTRIKE NDERMJET KESH SH.A. DHE OSHEE SH.A PER TEPRICAT E ENERGJISE ELEKTRIKE, PËRFSHIRE TEPRICAT NE KUSHTET E PRURJEVE TE MEDHA, ME QELLIM PLOTESIMIN E HUMBJEVE NE RRJETIN E SHPERNDARJES PER PERIUDHEN KOHORE 01.07.2016-31.12.2016**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Nenin 5 pika 4 të VKM nr. 244 dt 30.03.2016, "Per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te shërbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike, te diet ushtrojne aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", dhe nenit 26 të Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96 datë 23.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 25.08.2016 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE për fillimin e procedures per miratimin e kontrates per shit-blerjen e energjise elektrike ndermjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a per tepricat e energjise elektrike, perfshire tepricat ne kushtet e prurjeve te medha, me qellim plotesimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per periudhen kohore 01.07.2016-31.12.2016,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin Nr 26, Datë 09.03.2016, ERE ka vendosur shtyrjen e afatit të marrëveshjes për shit – blerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, deri në **30.06.2016**.
- KESH sh.a. me shkresën nr.7017 prot, date 2.8.2016 ka paraqitur ne ERE per miratim kete draft kontrate e cila eshte dakortësuar edhe nga ana e OSHEE sh.a. ne séance dëgjimore të zhvilluar nga ERE në date 09/08.2016.
- U konstatua se ndryshimet ne kete marrveshje, referuar permbajtjes se marreveshjes miratuar me heret me vendimin nr 12 date 06.02.2015 të ERE, e shtyre me vone me vendimin nr 26, Datë 09.03.2016 te Bordit te ERE, kane reflektuar parashikimet e VKM 244 date 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e

*energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” si dhe legjislacionit në fuqi.*

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të filloje procedurën për miratimin e kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.07.2016-31.12.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.